

KISHA E SHËN NËNË TEREZËS NË DUGAJEVË

*Nga Ëndrra në Realitet
Besim, Sakrificë dhe Dashuri*



SHËN NËNË TEREZA – FRYMËZIMI YNË



"Jo të gjithë mund të bëjmë gjëra të mëdha, por mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe."



RRËNJËT E KISHËS SË SHËN NËNË TEREZËS NË DUGAJEVË

Pas luftës së fundit në Kosovë, banorët e Dugajevës, të mbijetuar nga vuajtjet dhe shkatërrimet të mëdha, ndien nevojën të falënderonin Zotin për mbrojtjen dhe mbijetesën e tyre. Nga ky besim dhe mirënjohje lindi dëshira për ndërtimin e një kishe kushtuar Shën Nënë Terezës.




NJË VEND I VEÇANTË NË HISTORINË E KISHËS KATOLIKE

*Kisha e Parë në Botë me Pajtores Shën
Nënë Terezën*

*Me dëshirën e banorëve të Dugajevës
dhe me mbështetjen e famullitarit
Dr. Dom Gjergj Gjergji, kisha mori Nënë
Terezën si pajtores të saj. Pas
Lumturimit të saj më 19 tetor 2003,
kisha në Dugajevë u bë kisha e parë në
botë me Pajtores Nënë Terezën, duke
zënë një vend të veçantë në historinë e
Kishës Katolike.*

*Nënë Tereza u shpall e Shenjtë më
vonë, më 4 shtator 2016, nga Papa
Françesku.*




NJË VEND I VEÇANTË PËR BESIMTARËT

*Kisha e Shën Nënë Terezës në Dugajevë
u bë qendër e jetës shpirtërore të
dugajegasve dhe simbol i besimit,
shpresës dhe bashkimit. Për vite me
radhë, ajo shërbeu si vend lutjeje,
kremtimesh fetare dhe mikpritjeje për
besimtarë, vizitorë e pelegrinë nga
vende të ndryshme.*



DËMTIMET DHE NEVOJA PËR NDËRTIM TË RI

Me kalimin e viteve, kisha u përball me dëmtime të konsiderueshme strukturore. Gjendja e saj nuk garantonte më sigurinë dhe qëndrueshmërinë e nevojshme, prandaj lindi nevoja për ndërtimin e një kishe të re, më të sigurt dhe më të denjë.



"Çdo brez ka përgjegjësinë të ruajë dhe të forcojë trashëgiminë e besimit."

VENDIMI PËR NDËRTIMIN E KISHËS SË RE

*Duke parë gjendjen e kishës
ekzistuese dhe nevojën për një
objekt më të sigurt e më të
denjë, dugajevasit vendosën të
ndërmarrin ndërtimin e një
kiske të re kushtuar Shën Nënë
Terezës. Ky vendim u bë realitet
falë përkushtimit të banorëve,
diasporës dhe miqve të kishës.*



"Nga nevoja lindi vendimi, nga vendimi lindi projekti."

FILLIMI I PUNIMEVE

Pas përgatitjeve të nevojshme dhe hartimit të projektit, nisën punimet për ndërtimin e Kishës së re të Shën Nënë Terezës në Dugajevë. Me fillimin e punimeve mori jetë një vizion i përbashkët, i lindur nga besimi, përkushtimi dhe dëshira për t'i lënë brezave të ardhshëm një shtëpi të denjë të Zotit.




<https://kirche-mutter-teresa-dugajev-kosovo.com/hello-world/>



"Çdo vepër e madhe fillon me hapin e parë."



VAZHDI I PUNIMEVE

Punimet vazhduan me realizimin e armaturës, betonimit dhe pllakës bazë, duke krijuar bazën e fortë për ndërtimin e Kishës së re të Shën Nënë Terezës në Dugajevë.



NGRITJA E STRUKTURËS


Pas përfundimit të pllakës bazë, filloi ngritja e kolonave dhe mureve të kishës. Me çdo hap të ri ndërtimi, objekti merrte formë dhe vizioni i projektit bëhej gjithnjë e më i dukshëm.



KISHA MERR FORMË



Me përfundimin e pjesës më të madhe të strukturës, forma arkitektonike e Kishës së Shën Nënë Terezës u bë gjithnjë e më e dukshme.



KONSTRUKSIONI I KULMIT

Me vendosjen e konstruksionit të kulmit, kisha fitoi edhe më qartë identitetin e saj arkitektonik. Kjo fazë përbënte një hap të rëndësishëm drejt përfundimit të objektit.

Kisha Nën Kulm

DRITARET DHE DYERËT


Pas përfundimit të strukturës kryesore, vazhduan punimet me vendosjen e dritareve dhe dyerve, duke i dhënë objektit më shumë funksionalitet dhe dritë natyrore.



PUNIMET E BRENDSHME

Në fazën e punimeve të brendshme u realizuan instalimet teknike, suvatimi i mureve, përgatitja e dyshemesë, realizimi i estrihut, vendosja e pllakave qeramike dhe përgatitja e hapësirave liturgjike. Kisha filloi të shfaqte gjithnjë e më shumë bukurinë, funksionalitetin dhe karakterin e saj përfundimtar.





ALTARI DHE HAPËSIRA LITURGJIKE

Me përfundimin e altarit dhe hapësirës liturgjike, Kisha e Shën Nënë Terezës fitoi zemrën e saj shpirtërore. Kjo hapësirë e shenjtë u përgatit për kremtimin e Meshës së Shenjtë, Eukaristisë dhe sakramenteve.

VENDOSJA E BANKAVE DHE MOBILIMI I KISHËS

*Me vendosjen e
bankave dhe
elementeve të tjera
të mobilimit,
ambienti i
brendshëm i kishës
mori pamjen e tij
përfundimtare, duke
krijuar një hapësirë
të rregullt,
mikpritëse dhe të
denjë për jetën
shpirtërore të
besimtarëve.*



REZULTATI I NJË PËRKUSHTIMI TË PËRBASHKËT



Nga ideja dhe projekti deri te realizimi, Kisha e Shën Nënë Terezës në Dugajevë është dëshmi e besimit, përkushtimit dhe bashkëpunimit të shumë njerëzve. Çdo gur, çdo kontribut dhe çdo lutje u bënë pjesë e kësaj veprë që sot qëndron krenare në Dugajevë. Falënderim i veçantë për të gjithë donatorët, bujaria, zemërgjerësia dhe solidariteti i të cilëve e bënë të mundur shndërrimin e kësaj ëndrre në realitet.

HAPI I FUNDIT DREJT PËRFUNDIMIT TË PLOTË

Punime që mbeten për t'u realizuar:

✓ *Përfundimi i fasadës së jashtme*

✓ *Renovimi i Rrugës së Kryqit*

✓ *Rregullimi i ambientit të jashtëm*



FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN DHE MBËSHTETJEN TUAJ!

*"Nuk ka rëndësi sa japim, por sa dashuri vendosim në atë që japim."
– Shën Nënë Tereza*

STAFI ORGANIZATIV

Kisha e Shën Nënë Terezës në Dugajevë

Zoti ju bekoftë!